



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 671/4 Prot.

Tiranë, më 01 / 08 / 2019

V E N D I M

Nr. 103., Datë 01 / 08 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 41 Regj., datë 03.05.2019, e subjektit ankues P. K, kundër Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Korçë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës”, “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, jeton në godinën e ish-Konviktit të Shkollës së Ndërtimit prej 25 vitesh. Ajo shprehet se të gjithë banorët e kësaj godine kanë patur matës uji të përbashkët dhe në këto kushte pagesa ishte caktuar në mënyrë të barabartë (aforfe) për secilën familje në shumën prej 1600 lekësh. Ankuesja shprehet se për shkak se kishte pagesa të shumta të palikujduara fatura i shkonte në shumën 5000 dhe 6000 mijë lekë, shumë e cila ishte e lartë dhe ajo nuk e shlyente dot. Në këto kushte, në Janar të vitit 2018 ankuesja ka nënshkruar një Akt-Marrëveshje me Ujësjetllës-Kanalizimet (UK) Korçë, e cila specifikonte se ajo duhet të shlyente çdo muaj detyrimin prej 500 lekësh + faturën aktuale. Kjo gjë do të vijonte deri në shlyerjen e plotë të detyrimit nga ana e P. K. Subjekti ankues shprehet se nga ana e UK Korçë është respektuar kjo Akt-Marrëveshje deri në

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

muajin Janar 2019, kur asaj i është kërkuar nga punonjësit e kësaj Shoqërie të paguajë faturën e prapambetur prej 7000 lekësh + faturën aktuale. P .K shprehet se jeton vetëm me të ardhurat që përfiton nga pagesa e paaftësisë dhe nuk ka mundësi të paguajë çdo muaj një shumë të tillë.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit nga ana e UK Korçë, për shkaqet sipërcituara dhe marrjen e masave për respektimin e Akt-Marrëveshjes.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.671/1 prot., datë 10.05.2019 i është kërkuar informacion Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Korçë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

²Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Me shkresën me nr.179/1 prot., datë 23.05.2019 UK Korçë ka dërguar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe ka informuar Komisionerin se:

“Pranë ndërtesës së ish-Konviktit të Shkollës së Ndërtimit, ndërtesë në të cilën banon edhe ankuesja, aktualisht jetojnë rreth 30 familje, të cilat furnizohen me ujë me anë të një matësi të përbashkët, pasi teknikisht është e pamundur të instalohen matësa të veçantë për çdo familje. Konsumi mesatar mujor i gjithë godinës shkon mesatarisht 2.000 m³ujë në muaj dhe UK Korçë fillimisht e ka shpërndarë në mënyrë të barabartë për çdo familje këtë sasi. Ankuesja nuk është paraqitur asnjëherë pranë UK Korçë, që prej datës 03.12.2008 për të kryer ndonjë pagesë. Në datën 30.01.2018 klientja P. K është paraqitur pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Konsumatorin ku i është bërë me dije shuma totale e detyrimit pranë Shoqërisë tonë. Klientja është ankuar për sasinë e ujit të faturuar pasi jeton vetëm dhe nuk ka mundësi ekonomike të paguajë.

Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin pasi shqyrtoi situatën ekonomike të klientes që prej muajit Mars 2018 e në vazhdim e ka faturuar me 6 m³ujë në muaj, sasi normale për konsum mujor të një personi dhe minimale në krahasim me konsumin e ujit të ndërtesës ku jeton klientja.

Nëpërmjet Akt-Marrëveshjes me nr.128, datë 30.01.2018 klientja ka rënë dakord që duke filluar nga data 30.01.2018, për çdo muaj në vazhdim, së bashku me shlyerjen e faturës së muajit aktual, do të paguajë dhe shumën prej 5.000 lekësh, ose në pamundësi pagese të shlyejë një nga faturat e prapambetura, përfshirë kamatë vonesën. Shuma e detyrimit në momentin e nënshkrimit të kësaj akt-marrëveshjeje ishte 644.627 lekë dhe është nënshkruar me një pagesë 5.000 lekë në muaj duke supozuar që ky detyrim të shlyhet në një periudhë 11 vjeçare nëse klientja do të kryente çdo muaj pagesa, gjë që nuk është respektuar nga P.K.”

UK Korçë informoi gjithashtu se, megjithëse ankuesja dhe banorët e kësaj godine, në të cilën ajo jeton, kanë qenë gjithmonë debitorë, ata nuk e kanë ndërprerë asnjëherë furnizimin me ujë.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", nëpërmjet shkresës nr.671/3 prot., datë 16.07.2019, Komisioneri iu drejtua palëve të interesuara në proces, ku i njoftoi për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Nëpërmjet e-mailit³ të datës 26.07.2019, UK Korçë informoi Komisionerin se kanë nënshkruar një Akt-Marrëveshje të re me subjektin ankues P. K, në të cilën është dakortësuar me klienten se duke filluar nga data 26.07.2019, për çdo muaj në vazhdim, së bashku me shlyerjen e faturës së muajit aktual, do të paguajë dhe shumën prej 1000 lekësh, ose në pamundësi pagese të shlyejë një nga faturat e prapambetura, përfshirë kamatë vonesën. Meqenëse kjo Akt-Marrëveshje përfaqëson vullnet dypalësh mes klientes P. K dhe Shoqërisë UK Korçë ata e konsiderojnë të zgjidhur këtë problematikë të ngritur nga ankuesja, për këtë arsye nuk do të paraqiten në seancën e njoftuar.

³ Emaili: zmk@ukko.al i Zyrës së Marrëdhënieve me Konsumatorin pranë UK Korçë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodri postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Nga ana tjetër, subjekti ankues⁴, ka kërkuar ndërprerjen e procedurës hetimore nga ana e Komisionerit, për shkak se konsideron të përmbushur në thelb qëllimin për të cilin kishte iniciuar ankesën.

Neni 33, pika 9 e LMD ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin dhe kishte iniciuar ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), c), si dhe nenin 33, pikat 9, 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenin 94, pika 1 e Kodit të Procedurës Administrative,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës së P. K, kundër Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a Korçë, pasi u arrit efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Raca, gjendja ekonomike, gjendja shëndetësore

⁴ Nëpërmjet deklaratimit verbal para Specialistes së Drejtorisë së Pritjes së Ankesave të KMD-së / Zyra Rajonale Korçë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al